



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
Lagjja Administrative Nr.2 Kamëz

PROCESVERBAL

KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN E BASHKISË KAMËZ 2024-2026

I mbajtur 27.10.2023 në orën 16:30 , në dëgjesën me banorët e Njesisë Administrative nr.2 në lidhje me projekt-buxhetin e 2024-2026. Takimi u zhvillua në pallatin e kulturës “Artan Cuku”.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamë, Z. Rakip Suli;
- Adminstratori i njësisë administrative nr.2, Blerta Matraku;
- Ndërlidhësi me komunitetin, Idriz Cara;
- Qytetarët e zones;

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administatores së Njesisë Administrative nr.2, Blerta Matraku, ku i njohu qytetarët për qëllimin e takimit. Më pas fjalën e mori kryetari i Bashkisë Kamëz, Z.Rakip Suli. Pasi falënderoi pjesëmarrësit e takimit bëri një përmbledhje të investimeve të kryera deri më tani në infrastrukturë, arsim dhe çështje sociale. Disa nga prioritetet kryesore të përfshira në projekt-buxhet të vitit 2024-2026 ishin:

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore
- Ndërtimi i një parkimi nëntokësor (te stadiumi)
- Ndërtimi i një kopshti me ushqim
- Ndërtimi i pedonales së Frutikulturës
- Ndërtimi i këndit të lojërave
- Shtimi i hapësirave të gjelbërta

Në fund u zhvillua dhe dëgjesa e pyetjeve dhe përgjigjeve me banorët e pranishëm. Qytetarëve ju bë me dije se të gjitha rekomandimet dhe shqetësimet e tyre do të merren parasysh dhe do të implementohen në projekte që përbëjnë buxhetin e bashkisë Kamëz për vitin 2024-2026.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
Lagjja Administrative Nr.2 Kamëz

